

MIRATOHET
DREJTORIA E RAJONIT QËNDËR LINDJE KORÇË
DREJTORI
ARDIT MELE

RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë : Korçe- Erseke (Rruga e re) L= 34.2 km, dhe Deg.Q.e Qarrit-Erseke(Rruga e vjeter) L= 25.1 km (Kontrata Nr 3) L= 55.9 km

• **Segmentet që mbulon kontrata**

Nr rruges	Emërtimi i rrugës	Koordinatat e fillimit	Koordinatat e mbarimit	Gjatësia (km)	Gjerësia (m)
75	Korçe-Qafa e Qarrit (rruga e re ekzistuese)	N 40°36'31.4" E 20°46'33.4"	N 40°29'01.5" E 20°40'24.8"	17.2	7
W 60	Qafa e Qarrit -Erseke (rruga e re)	N 40°29'01.5" E 20°40'24.8"	N 40°20'39.4" E 20°41'00.5"	17.2	7
75	Deg.Q.Qarrit- Erseke (rruga e vjeter)	N 40°29'01.5" E 20°40'24.8"	N 40°20'35.6" E 20°41'16.1"	21.5	5
SHUMA TOTALE E KONTRATËS 3				55.9	

• **Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga**

Korçe – Qafa e Qarrit -Erseke (Rruga e re ekzistuese dhe rruga e re ne ndertim) nga km 0+000 deri ne km 34+400

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aks rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale

Ky aks rrugor lidh qytetin e Korces me ate te Ersekës, Leskovikut, Permetit dhe Gjirokastrës. Është nje aks rrugor nacional i juglindjes me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Eshte i ndare ne 2 segmente rrugore per arsye te specifikave te tij.

Segmenti i pare fillon nga qyteti Korçe – Qafa e Qarrit(harta 1) me gjatesi L=17.2 km

Ky segment eshte ndertuar i ri ne vitet 2015-2018 me gjerresi rruge 7 m dhe me dy sense Levizjeje.

Eshte segment rrugor i asfaltuar ne gjendje te mire me nevoja te vogla per riparime.

Kanalet anësore, kunetat dhe tombinot kane nevoje per mirembajtje te vazhdueshme.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme dhe te vazhdueshme,

Per sinjalistikën horizontale duhen vijëzime të reja pasi ato amortizohen me kalimin e kohës.

Ne segmentin e parë nga km 14+400 derri në km 17+200 rruga kalon në një terren malor ku në të dyja anët e rrugës kemi mure prites. Mbi kokat e tyre shtrihen skarpata me lartësi të konsiderueshme dhe me perberje materjali ultabazik i cili ka rrjedhje dhe shkarja nga skarpata në drejtim të rrugës sidomos në përdhën me rreshje dhe në përdhën dimerore.

E gjithë zona ka shembje të vazhdueshme të materjaleve nga skarpata, mbushjen e hapësirave rezerve pas mureve prites dhe daljen e tyre në rrugë duke krijuar probleme në qarkullim. Kjo zonë kërkon punime të vazhdueshme për pastrimin e shembjeve dhe aluvioneve të ngurta nga trupi i rrugës, pastrimin e mureve prites.

Duhet parë me perparësi edhe mbrojtja e skarpatave anësore në vendet me problematike.

Në km 15+600, në anën e majtë në një gjatësi prej 30 m ka cedim të rrugës dhe demtim të murit prites prej betoni. Njëkohësisht, në karexhatë ka demtim të shtresës asfaltike në një gjatësi prej 10 m.

Në km 17. 2, ka demtim të skarpatave të rrugës në krahun e djathtë. Për këtë mbas inspektimit në vend me grup punë nga Arrsh, DRQL Korce, dhe supervizorit, nisur nga rrezikshmëria e lartë, është vendosur të nderhyhet urgjentisht në vitin 2024 për pastrimin e materjaleve të skarpatës dhe ndertimin e murit mbajtës prej betoni me fondet e mirëmbajtjes periodike.

Segmenti i dytë fillon mja e Qafes së Qarrit - Erseke (harta 2) me gjatësi L= 17.2 km .


Eshtë segment rrugor në ndërtim të sipër. (rrugë e re, në gjurmë të re), me shtrirje nga Qafa e Qarrit drejt luginës së Mollasit e me tej në drejtim të Ersekës me pike takimi, Unazën Erseke.

Ka një karexhatë me dy sense levizje me , gjerësi të rrugës 7 m.


Rruga është në terren malor dhe tepër malor me një karexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit të mirëmbajtjes është “i mirë”.

Harta 1



Harta 2





II. Deg.O.Qarrit- Erseke (Rruga e vjeter), L = 21.5 km (nga km 17.200 deri ne 38.700)

Ne V.K.M. Nr.234 date 17.04.2024 ky aks rrugor eshte pjese e inventarit te rrugeve nacionale

Ky është vazhdim i segmentit Korçe- Erseke, i cili fillon ne Q. E Qarrit e perfundon ne qytetin e Ersekës. Eshte pjese rruges se vjeter ende ne shfrytezim . Korçe – Qafa e qarrit – Erseke.

Pjesa nga km 17+500 - km 38 + 800 me shtrirje 21.5 km eshte rruge teper e vjeter me moshe te madhe ndertimi

Shtresat rrugore asfaltike, jane teper te amortizuara.Kane nevojte te madhe per punime profilime, shtersa binderi dhe riveshje pjesore me shtrese asfaltobetoni t= 4 cm.

Në këtë segment, është nderhyrë disa here për rrvëshje të karexhates , po kështu edhe në sinjalistikën horizontale edhe vertikale

Theksojmë se ky segment, është i ndërtuar, vite më parë, dhe duke qenë se ky aks përballon qarkullimin për në Ersekë , është nderhyrë vazhdimisht , si në mirëmbajtjen rutine po ashtu edhe në mirëmbajtjen periodike.


Kanalet anësore, kuletat dhe tombinat kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme dhe të vazhdueshme,

Për sinjalistikën horizontale duhen vijëzime të reja pasi ato amortizohen me kalimin e kohës.

Rruga është në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit të mirëmbajtjes është “i mirë”.





GRUPI I PUNES